

Në bazë të nenit 18 dhe 19 të Ligjit për informimin publik dhe mediat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë", nr. 92/2023), Rregullores për kushtet dhe kriteret e përputhshmërisë së ndihmës shtetërore në fushën e informimit publik ("Gazeta Zyrtare RS", nr. 9/22), Rregullores për bashkëfinancimin e projekteve për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik ("Gazeta Zyrtare RS", nr. 6/2024 dhe 106/24), Vendimit për buxhetin e Komunës së Preshevës për vitin 2026 ("Gazeta Zyrtare e Komunës së Preshevës", nr. 12/24), si dhe Vendimit për përcaktimin e llojit të konkursit që shpallet për bashkëfinancimin e projekteve nga buxheti i Komunës së Preshevës për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në vitin 2026. dhe për përcaktimin e shumës së mjeteve për realizimin e konkursit III.nr.400-35,

KOMUNA E PRESHEVËS **Këshilli Komunal**

Sh p a ll

KONKURS

Për bashkëfinancimin e projekteve për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në territorin e Komunës së Preshevës për vitin 2026.

1. Lënda e konkursit

Konkursi shpallet me qëllim të ofrimit të mbështetjes financiare për projektet e prodhimit të përmbajtjeve mediatike që kontribuojnë në realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në territorin e Komunës së Preshevës, të përcaktuar me nenin 15 të Ligjit për informimin publik dhe mediat. Konkursi publikohet në Sistemin e Unifikuar Informativ për zbatimin dhe monitorimin e bashkëfinancimit të projekteve në fushën e informimit publik (në tekstin e mëtejshëm: **JIS-SUI**) në adresën jis.mit.gov.rs dhe në faqen zyrtare të Komunës së Preshevës www.presevo.rs

Mjetet e ndara me Vendimin për shpalljen e konkursit për bashkëfinancimin e projekteve për prodhimin e përmbajtjeve mediatike në territorin e Komunës së Preshevës janë te parapara me buxhetin e vitit 2026: **1.000.000,00 dinarë**

Shuma minimale që mund të miratohet për një projekt është: 100.000,00 dinarë ,
Shuma maksimale për projekt është: 300.000,00 dinarë

Konkursi shpallet dhe mjetet ndahen për projekte realizimi i të cilave mund të zgjasë deri në një vit nga dita e marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve.

Me rastin e lidhjes së kontratës me secilin përfitues caktohet afati për realizimin e projektit, në përputhje me planin e aktiviteteve të projektit.

2. E drejta e pjesëmarrjes në konkurs

Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë:

- 1) botuesi i medias, media e të cilit është e regjistruar në Regjistrin e Mediave në përputhje me Ligjin dhe që ka autorizimin përkatës për ofrimin e shërbimit mediatik

në përputhje me ligjin që rregullon mediat elektronike, përkatësisht që është i regjistruar në Regjistrin e Shërbimeve Mediatike që mbahet nga Trupi Rregullator për Media Elektronike, kur bëhet fjalë për media elektronike;

- 2) subjekti që merret me prodhimin e përmbajtjeve mediatike dhe që është i regjistruar në Evidencën e Prodhuesve të Përmbajtjeve Mediatike dhe që dorëzon dëshmi jo më të vjetër se 30 ditë se përmbajtja mediatike e bashkëfinancuar do të realizohet përmes medias që i plotëson kushtet nga pika 1.

Pjesëmarrës në konkurs për prodhimin e përmbajtjeve mediatike në formë të shtypur dhe digjitale mund të jenë vetëm: ndërmarrje mikro, ndërmarrje të vogla, ndërmarrje të mesme.

Nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje:

- 1) botuesit ose prodhuesit e përmbajtjeve mediatike me të njëjtin projekt që është mbështetur në konkurs të Republikës së Serbisë, krahinës autonome ose njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe për të cilin është dorëzuar raport realizimi;
- 2) botuesit ose prodhuesit e përmbajtjeve mediatike që nuk kanë futur të dhënat dhe dokumentet në JIS-SUI;
- 3) botuesit me media në të cilat nuk janë publikuar të dhënat bazë të medias në formë impresumi;
- 4) personat juridikë dhe sipërmarrësit që financohen nga të ardhurat publike;
- 5) aplikuesit që kanë marrë mjete në konkurs dhe nuk kanë dorëzuar në afatin e paraparë raportin narrativ dhe financiar dhe përmbajtjen e prodhuar mediatike ose dëshminë për realizimin e projektit;
- 6) aplikuesit që kanë marrë mjete dhe është konstatuar se i kanë shpenzuar në mënyrë jo të rregullt ose nuk kanë përmbushur obligimet kontraktuale;
- 7) personat që janë në procedurë kthimi të ndihmës shtetërore ose ndihmës de minimis, si dhe personat që kanë qenë në vështirësi sipas rregullave për kontrollin e ndihmës shtetërore.

3. Kushtet për pjesëmarrje në konkurs

Projekti sipas Ligjit nënkupton një tërësi programore ose pjesë të saj (sipas zhanrit dhe kohëzgjatjes) që kontribuon në realizimin e interesit publik sipas nenit 15 të Ligjit.

Mjetet ndahen për prodhimin e përmbajtjeve të reja mediatike sipas aktiviteteve të planifikuara në projekt, ku pjesa e përmbajtjeve të marra nga burime të tjera ose materialeve arkivore nuk mund të jetë më shumë se 20%, ndërsa ato duhet të jenë të shënuara qartë.

Materiali dokumentar (video, audio dhe fotografi) që përdoret si ilustrim nuk përfshihet në këtë përqindje.

Projekti, në kuptim të Ligjit, **nuk nënkupton ndjekjen e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, sportive dhe ngjarjeve të tjera në baza ditore** (lajme, emision qendror informativ, program mëngjesi, përmbledhje ditore dhe të ngjashme).

Në Konkurs mund të aplikohet vetëm **me një projekt**.

Botuesi i disa mediave mund të aplikojë **me një projekt për prodhimin e përmbajtjeve mediatike për secilën media**.

• Pjesëmarrësi në konkurs (media të shtypura, radio dhe internet) mund të paraqesë kërkesë për bashkëfinancimin e projektit në një shumë që **nuk tejkalon 80% të shpenzimeve të pranueshme të vlerës së projektit**, dhe më së shumti deri në shumën e përcaktuar me konkurs.

• Pjesëmarrësi në konkurs për prodhimin e përmbajtjeve mediatike për televizione mund të paraqesë kërkesë për bashkëfinancimin e projekteve në një shumë që **nuk tejkalon 50% të shpenzimeve të pranueshme të vlerës së projektit**, dhe më së shumti deri në shumën e përcaktuar me konkurs.

Pjesëmarrësi në konkurs duhet të sigurojë pelqimin e Kshillit nacional shqiptar për projektin me të cilin konkuron

Përjashtimisht nga paragrafi i mëparshëm, në përputhje me kushtet dhe kriteret për dhënien e ndihmës shtetërore në fushën e informimit publik, në përputhje me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit, pjesëmarrësi në konkurs për prodhimin e përmbajtjeve mediatike për televizione mund të paraqesë kërkesë për bashkëfinancimin e projekteve në një shumë që **nuk tejkalon 80% të shpenzimeve të pranueshme**, nëse aplikohet për projekte të prodhimit të përmbajtjeve mediatike **për të cilat nuk parashihet shfrytëzim komercial**, dhe atë për:

1. prodhimin e përmbajtjeve mediatike të destinuara për grupe shoqërore të ndjeshme, siç janë fëmijët dhe të rinjtë, gratë, personat e moshuar, personat e rrezikuar socialisht dhe shëndetësisht, personat me aftësi të kufizuara, pjesëtarët e komunitetit LGBT, pjesëtarët e pakicave etnike etj.;
2. prodhimin e përmbajtjeve mediatike që janë të destinuara për ruajtjen dhe shprehjen e identitetit kulturor si të popullit shqiptar ashtu edhe të pakicave kombëtare tjera që jetojnë në komunën e Presheves si dhe të tjereve pjesëtar, duke pasur parasysh që pakicat kombëtare të ndjekin programe të caktuara në gjuhën dhe shkrimin e tyre amtare;
3. prodhimin e përmbajtjeve mediatike që promovojnë dhe afirmojnë tema nga fusha e shkencës, arsimit të përgjithshëm, duke përfshirë edhe edukimin mediatik si pjesë e sistemit arsimor, edukimin shëndetësor dhe edukimin në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Mjetet që ndahen në Konkurs, në përputhje me kushtet dhe kriteret për dhënien e ndihmës shtetërore në fushën e informimit publik, **nuk guxojnë të kontribuojnë në rritjen e mjeteve themelore të përfituesit**, përkatësisht në zgjerimin e veprimtarive ekzistuese, as në bashkimin e mediave dhe themelimin dhe/ose regjistrimin e pjesëmarrësve të rinj në treg.

Shpenzimet e pranueshme janë shpenzimet e krijuara në lidhje me prodhimin e përmbajtjes mediatike, e në veçanti:

1. shpenzimet e vlerësuara bruto për paga dhe honorare të personave të angazhuar në prodhimin e përmbajtjeve mediatike;
2. shpenzimet e qirasë për hapësira, pajisje, lokacione dhe pasuri të tjera të nevojshme materiale dhe jomateriale për prodhimin e përmbajtjeve mediatike;
3. shpenzimet e përdorimit të pasurisë vetjake (amortizimi);

4. shpenzimet për futjen e teknologjive të reja me qëllim përmirësimin e shërbimit të informimit publik (digjitalizimi, përshtatja e përmbajtjeve mediatike për personat me aftësi të kufizuara etj.);
5. shpenzimet për hulumtime të vogla që kanë për qëllim kuptimin më të mirë të zakoneve të përdorimit të mediave, nivelin e edukimit mediatik dhe pozitën e grupeve shoqërore të ndjeshme në media.

Nëse pjesëmarrësi në treg, përveç prodhimit të përmbajtjes konkrete mediatike, kryen edhe veprimtari të tjera që lidhen me prodhimin e përmbajtjeve mediatike ose njëkohësisht prodhon disa përmbajtje mediatike duke përdorur të njëjtat burime (p.sh. njerëzore, materiale ose jomateriale), në shpenzimet e pranueshme përfshihet **pjesa proporcionale e shpenzimeve të përbashkëta të prodhimit.**

Pjesa proporcionale e shpenzimeve të përbashkëta llogaritet në bazë të çmimit të tregut për përdorimin e burimeve ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme që mundëson llogaritjen e pjesëmarrjes në shpenzimet e përbashkëta.

Shpenzime të pranueshme **nuk konsiderohen:**

- shpenzimet e shtypjes
- shpenzimet e shpërndarjes
- shpenzimet e promovimit të përmbajtjes mediatike

Pjesëmarrësi në konkurs, i cili nuk disponon kapacitete të përshtatshme, mund të angazhojë një botues media e të cilit është e regjistruar në Regjistrin e Mediave në përputhje me ligjin, përkatësisht një person që merret me prodhimin e përmbajtjeve mediatike, për prodhimin e përmbajtjes mediatike vlera e së cilës **nuk tejkalon 20% të shumës së mjeteve të ndara nga organi për realizimin e projektit.**

4. Kriteret për vlerësimin e projekteve

Kriteret e përgjithshme:

1. masa në të cilën aktivitetet e propozuara të projektit janë të përshtatshme për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik, në përputhje me nenin 15. të Ligjit; dhe
2. masa në të cilën media përmes së cilës do të realizohet projekti respekton standardet profesionale dhe etike.

Në bazë të kriterëve nga paragrafi 1 pika 1 e këtij neni, në mënyrë të veçantë vlerësohen:

1. rëndësia (relevanca) e projektit;
2. realizueshmëria e projektit;
3. monitorimi i realizimit të projektit;
4. kapacitetet e propozuesit të projektit;
5. qasja e përmbajtjes për grupin e synuar;
6. buxheti dhe arsyeshmëria e shpenzimeve.

Në bazë të kriterëve nga paragrafi 1 pika 2 e këtij neni, në mënyrë të veçantë vlerësohen:

1. nëse medias përmes së cilës do të realizohet projekti i janë shqiptuar masa nga organet shtetërore, Trupi Rregullator për Media Elektronike ose Këshilli për Shtyp, gjatë vitit kalendarik paraprak, për shkak të shkeljes së standardeve profesionale dhe etike;
2. pesha e shkeljes dhe shpeshësia e përsëritjes së saj.

Kriteret më të detajuara:

Trajtimi i temave: ruajtja e identitetit shqiptar dhe identitetit të pakicave dhe nacionaliteteve tjera që jetojnë në territorin e Komunës së Preshevës me ç'rast afirmohet veçantia e tyre si dhe ruajtja e gjuhës shqipe dhe gjuhës së minoriteteve dhe nacionaliteteve tjera që jetojnë në komunën e Preshevës; kultivimi i tolerances politike, ndëretnike dhe ndërftare si dhe format e tjera të tolerancës dhe mirëkuptimit; parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi; kultura e dialogut publik; luftimi i gjuhës së urrejtjes dhe lajmeve të rreme në media; siguria e fëmijëve në internet; edukimi mediatik; sundimi i ligjit; mbrojtja e të dhënave personale, veçanërisht e të dhënave të të miturve; roli dhe rëndësia e shoqërisë civile; vlerat shoqërore dhe familjare; nxitja e lindshmërisë; përmbajtje afirmative për fëmijë dhe të rinj; kultura e kujtesës; përmirësimi dhe zgjerimi i prodhimit bujqësor; parandalimi i abuzimit me substanca psikoaktive; mbrojtja e shëndetit seksual dhe riprodhues; parandalimi i keqpërdorimit të armëve; shëndeti publik dhe nevojat shëndetësore të popullsisë.

Përmirësimi i pozitës socio-ekonomike dhe shoqërore të personave me aftësi të kufizuara; pjesëmarrja politike dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës shoqërore; arsimi gjithëpërfshirës; jeta e pavarur dhe përfshirja në komunitet; mbrojtja sociale; zvogëlimi i rrezikut të përjashtimit social; mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara nga dhuna dhe keqtrajtimi në mjedisin familjar dhe institucional; rehabilitimi profesional dhe punësimi; qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike.

Pjesëmarrësit në Konkurs, përveç temave të lartpërmendura, mund të propozojnë edhe tema të tjera që kontribuojnë në realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik.

5. Dokumentacioni

Pjesëmarrësi i Konkursit është i detyruar që përmes **JIS-it-SUI** të dorëzojë projektin dhe të bashkëngjisë dokumentacionin në vijim:

1) Për projektet e prodhimit të përmbajtjeve mediatike:

1. **Aplikacionin për bashkëfinancimin e projektit – Formulari 1** (të plotësohet në JIS-SUI duke shtuar pjesët e kërkuara të formularit: Aktivitetet e projektit, Realizueshmëria e projektit, Monitorimi i realizimit të projektit, Kapacitetet për realizimin e projektit, Buxheti i projektit).
2. **Dëshmi (vërtetim jo më i vjetër se 30 ditë)** që përmbajtja mediatike do të publikohet në një media të regjistruar në Regjistrin e Mediave

- (e detyrueshme vetëm për personat që merren me prodhimin e përmbajtjeve mediatike dhe nuk janë botues mediash).
3. **Deklaratë e pjesëmarrësit (në formë të lirë)** se projekti nuk do të mund të realizohet pa ndarjen e ndihmës shtetërore, përkatësisht se projekti nuk do të mund të realizohet me ndonjë instrument tjetër të ndihmës shtetërore përveç subvencioneve – mjeteve të pakthyeshme.
 4. **Deklaratë e pjesëmarrësit (në formë të lirë)** se nuk ndodhet në procedurë për kthimin e ndihmës shtetërore ose **de minimis** dhe se nuk ka qenë në vështirësi në kuptim të rregullave për kontrollin e ndihmës shtetërore.
 5. **Deklaratë e pjesëmarrësit (në formë të lirë)** se përmbajtja e prodhuar nuk do të shfrytëzohet për qëllime komerciale.
 6. **Kopje e skanuar e faqes së parë dhe faqes me impresum** të numrit të fundit të gazetës ku do të publikohet përmbajtja mediatike (për mediat e shkruara).

6. Afatet

Aplikimet në konkurs dorëzohen në periudhën **nga 28 Prilli deri më 12 Maj 2026**.
Vendimi për ndarjen e mjeteve merret **më së voni brenda 90 ditëve nga dita e mbylljes së konkursit**.

7. Thirrje për pjesëmarrje në punën e Komisionit

Vlerësimin e projekteve të paraqitura në Konkurs e bën **komisioni profesional**, i cili emërohet nga **Këshilli Komunal i Komunës së Preshevës**.

Ftohen **shoqatat e gazetarëve dhe të mediave** që përmes **JIS-it-SUI** të propozojnë anëtarë të komisionit profesional.

Aplikimet dorëzohen përmes **JIS-it-SUI**, për **KONKURSIN për bashkëfinancimin e projekteve për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në territorin e Komunës së Preshevës për vitin 2026**.

8. Mënyra e aplikimit

Aplikimi i projekteve në **Konkursin për bashkëfinancimin e projekteve për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në territorin e Komunës së Preshevës për vitin 2026** bëhet **vetëm përmes JIS-it-SUI**

Aplikimet që **nuk i plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në konkurs**, si dhe aplikimet e dorëzuara **pas skadimit të afatit**, do të refuzohen.

Informata shtesë mund të merren gjatë ditëve të punës **nga ora 11:00 deri në 14:00** në zyrën e Drejtoratit për veprimtari shoqërore: **017-7151030**.

9. Publikimi i vendimit për ndarjen e mjeteve

Vendimi për ndarjen e mjeteve sipas konkursit të shpallur do të publikohet në JIS-SUI dhe në faqen zyrtare të **Komunës së Preshevës** (www.presevo.rs) dhe do t'u dërgohet të gjithë pjesëmarrësve të Konkursit në **formë elektronike**.

10. Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat e mbledhura gjatë zbatimit të Konkursit do të **përpunohen dhe ruhen në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale**.

KËSHILLI KOMUNAL KOMUNA E PRESHEVËS

III.nr: 111-4

Datë 20.04.2026



Kryetarja,
Ardita Sinani